

VENDIM
Nr. 37, datë 29.1.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Nga lista e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “a” të listës “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida-n me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTAT E OKB-SË)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e individëve të çregjistruar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. NABIL; BEN MOHAMED; BEN ALI; BEN ATTIA.
2. ATILLA; SELEK.

Shënim. Gjeneralitet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.